

Veprimtaria e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë për periudhën Janar - Qershor 2017

Bazuar në Neni 7 të Ligjit 9150 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH” i ndryshuar, po iu dërgojmë raportin për veprimtarinë e 6-të mujorit të parë të UFSH-së për vitin 2017.

Urdhri I Farmacistëve të Shqipërisë e ushtron veprimtarinë e tij, në mbështetje të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Veprimet e kryera në këtë periudhë në sektorit të antarësimit dhe regjistrimit pranë Urdhrit të Farmacistëve, kanë konsistuar në ndryshime të pozicionit të punës të farmacistit të punësuar, drejtuesit teknik, ndryshim të vendit të punës nga i punësuar në drejtues teknik, anëtarësime të reja si dhe dorëzim të certifikatave.

Është vënë re një fluks i madh i ndryshimeve të vendeve të punës, ku përmendim:

- 116 raste të ndryshimit të vendit të punës për drejtuesin teknik,
- 60 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga I punësuar në drejtues teknik,
- 98 raste të ndryshimit të vendit të punës për farmacistin e punësuar,
- 17 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga drejtues teknik në të punësuar.

Ndërsa përsa i përket ndryshimeve të vendit të punës për ndihmës farmacistë nuk ka raste të ndryshimit të vendit të punës si drejtues teknik në Agjenci Farmaceutike.

Gjatë kësaj periudhe ka patur 183 anëtarësime të reja, prej të cilëve 9 anëtarësime pasive. Nga ana tjetër kemi 6 raste të kalimit nga anëtarë pasiv në aktiv.

Kemi pasur 51 raste të dorëzimit të certifikatave nga ana e drejtuesve teknik, për arsye të tërheqjes nga vendi I punës apo mbyllje të aktivitetit përkatës. Nga ana tjetër përmendim edhe rastet e dypunësimit të farmacistëve të cilat shënojnë 46 raste për këtë periudhe.

Bazuar në Regjistrin Themeltar Kombëtar të anëtarëve të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, në formë elektronike dhe manuale, deri në fund të qershorit 2017 na rezultojnë gjithsej 2160 farmacistë në gjendje aktive, prej të cilëve 1498 drejtues teknik dhe 662 si farmacistë të punësuar.

Duke u bazuar në problematikën e Qendrës Kombëtare të Biznesit, në lidhje me farmacistët, të cilët në regjistrat e kësaj qendre vazhdojnë të figurojnë si drejtues teknik në më shumë se një subjekt, si rrjedhojë e faktit që raportimet në lidhje me ndryshimet përkatëse, mund të bëhen vetëm nga pronari i subjektit, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, për ti ardhur në ndihmë kësaj qendre, me informacione të përditësuara, që nga muaji shtator 2015, raporton cdo muaj në lidhje me ndryshimin e pozicionit të punës për secilin drejtues teknik.

Gjithashtu përsa iu përket gjykimeve disiplinore, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë ka ushtruar kontrolle në një numër të konsiderueshëm farmacish. Ajo që vihet re në pjesën më të madhe është fakti se në farmaci gjenden duke shërbyer persona jo farmacist. Për këtë Ministria e Shëndetësisë është vënë në dijeni here pas here me raste konkrete. Mbi këtë situatë jemi duke pritur reagimin e institucioneve përkatëse.